



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA E VIŠTITRËSE - OPSTINA VIŠITRË
Nr. / Nr. 308-1/11
Data: / Datum 28.04.2011



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari i Komunës

RAPORT
I PUNËS SE KRYETARIT TE KOMUNES PËR VITIN 2010

Mars 2011

I.

Ky raport është hartuar dhe bazuar në dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, Statutin e Komunës, si dhe akteve tjera juridike në fuqi.

Në këtë raport është paraqitë puna dhe aktivitetet e Kryetarit të komunës përkatësisht Ekzekutivit të komunës, në përmbushjen e detyrave nga fushëveprimtaria dhe kompetencat e tyre të përcaktuara me ligj.

Aktivitetet kyçe të Kryetarit të Komunës - Ekzekutivit të Komunës gjatë kësaj periudhe kanë qenë të përqëndruara në:

- realizimin e projekteve kapitale nga viti paraprak 2009 të cilat janë bartë për të u realizuar në vitin 2010,
- realizimin e projekteve që janë planifikuar për vitin raportues, si dhe projekteve që nuk kanë qenë të planifikuara por në kërkesë dhe financim apo bashkefinancim me donatorë të ndryshëm kanë mund të realizohen brenda vitit 2010,
- Shtimin e efikasitetit në realizimin sa më të madh të të hyrave buxhetore të komunës,
- menaxhimin sa më të mirë të pronës komunale,
- Bashkëpunimin e komunës me komunitetin për realizim të projekteve për komunitet,
- Bashkëpunimin e komunës me institucionet qendrore të Republikës së Kosovës për realizim të projekteve me interes për komunën dhe qytetarët,
- Bashkëpunimin me organizata të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare
- Bashkëpunimit me Policinë e Kosovës, ICO, EULEX, KFOR-in etj,
- Bashkëpunimin me Shoqatat e dalura nga lufta,
- Shtimin e efikasitetit dhe cilësisë në punë të shërbyesve civil me qëllim të ofrimit të shërbimeve sa më cilësore qytetarëve,
- Plotësimin e nevojave dhe kërkesave të qytetarëve me qëllim të përmirimit të kushteve të jetesës dhe ngritjes së mirëqenies së tyre,
- Mbikqyrjen dhe zbatimin e ligjshërisë në punë në institucionet e komunës,
- Ngritjen e nivelit të disiplinës në punë dhe përgjegjësisë ndaj punës, etj.

II.

Te nderuar anetar te kuvendit,

Në këtë raport fillimisht do të paraqitet puna dhe aktivitetet e kryetarit të komunës për v. 2010, në mënyrë që në vazhdim do të paraqiten punët dhe aktivitetet sipas drejtorive:

1. Angazhimet ditore – koordinimi i punëve me drejtor të drejtorive në bazë të dinamikës, detyrave dhe punëve ditore për kryerje sa më efektive të tyre,

2. Mbajtja e takimeve të rregullta javore me drejtor të drejtorive, përcaktimi i detyrave javore dhe raportimi për detyrat që janë kryer në baza javore,
3. Takimet e kohëpaskosme me palë për qështjet apo problemet me të cilat ata janë preokupuar,
4. Takimet e rregullta mujore me me palë për të dëgjuar hallet dhe problemet e tyre gjegjësisht për të adresuar ato te organet kompetente të komunës,
5. Takimet me qytetarë në tubime të ndryshme duke përfshi dy takimet obligative të parapara me ligj (njena në 6 mujorin e parë dhe takimi tjetër në 6 mujorin e dytë),
6. Takimet e ndryshme me zyrtar në nivel të komunës dhe nivel qendror institucional dhe jashtë instucional (shoqëria civile, etj.),
7. Takimet me përfaqësues të organizatave qeveritare dhe jashtëqeveritare vendore dhe ndërkombëtare,
8. Takimet me përfaqësues të ICO, EULEX-it, KFOR-it etj.
9. Takimet e rregulta mujore me Këshillin Komunal për siguri në Bashkësi,
10. Takimet e rregulta me grupin komunal për kthim,
11. Takimet me grupet e ndryshme të komuniteteve,
12. Propozimet për shqyrtim të materialeve të ndryshme nga plani i punës se kuvendit te komunes dhe atyre që nuk kanë qenë të përfshira ne planin e punës për v. 2010,
13. Pjesmarrja në mbledhjet e Komitetit për Politikë dhe Financa dhe Kuvendit të Komunës,
14. Përcjellja e zbatimit të detyrave të përcaktuara me planet e punës të ekzekutivit të komunës,
15. Mbikqyrja në zbatimin e rregulloreve dhe vendimeve të miratuara në Kuvendin e Komunës,
16. Mbikqyrja e realizimit të buxhetit të komunës për vitin fiskal,
17. Mbikqyrja e realizimit të projekteve kapitale te komunes,
18. Mbikqyrja në zbatimin e ligjshmërisë në punën e organeve komunale, shtimit të efikasitetit në punë dhe disiplinës në punë të nëpunësve civil etj.

Në procedurë të caktuar gjatë periudhës raportuese, Kryetari i Komunës në mbledhje të rregullta javore me drejtor te drejtorive ka shqyrtuar gjithsejtë 534 kërkesa, prej të cilave:

- 81, jane miratuar
- 114, jane refuzuar
- 339, jane proceduar në procedurë të mëtejme drejtorive përkatëse.

Ndërsa, janë nxjerrë 15 urdhëresa si dhe janë marrë 502 vendime.

Gjithashtu janë nënshkruar këto marrëveshje të mirëkuptimit:

- Marrëveshja mirëkuptimi me komunitetin per ngritjen e serrave,
- MM. me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal për bashkë financim të projektit për ndërtim të rrjetit të ujësjellsit në 10 fshatra të K. së Vushtrrisë,
- MM. me MAPL – bashkëfinancim për ndërtimin e kanalizimit të ujrave të zeza në fsh. Maxhunaj,
- MM. me MAPL – bashkëfinancim për projektin “ndërtimi i vend-ndaljeve për autobus me kabina si dhe sinjalizimi i disa rrugëve në qytet.”,

- MM me MAPL – bashkëfinancim për renovimin e objektit të ish TMK-së, rregullimi i fasadave të SHK. “H. Prishtina”,
- MM me komunitetin për asfaltimin e rrugës Dalak-Shtitaricë, lagja “Osmani”, “Smakolli”,
- MM me komunitetin e fsh. Gumnishtë, - bashkëfinancim për ndërtim të rrugës,
- MM me komunitetin e lagjes në Rr. “J.Terstena” për shtruarje me kubza betoni të kësaj rruge,
- MM me komunitetin – bashkëfinancim për rregullimin e sheshit “Hasan Prishtina” dhe pastrimi i mbeturinave,
- MM me komunitetin – bashkëfinancim për rregullimin me kubza betoni të Rr. “Hamdi Hajrizi”,
- MM me komunitetin – bashkëfinancim për rregullimin e rrjetit të ujësjellsit dhe shtruarjen me kubëza betoni të rr. “Sahit Avdulli”,
- MM me komunitetin - bashkëfinancim për shtruarjen me kubëza betoni të Rr. “Mehmet Pashë Zogaj”,
- MM. për bashkëfinancim me komunitetin për rregullimin me kubza betoni, të rrugës “Rushit Strofici”
- MM, për bashkëfinancim me komunitetin për rregullimin e rrugës “Shaban Polluzha” me kubëza betoni,
- MM, për bashkëfinancim me komunitetin për rregullimin e rrugës “Gjon Buzuku” me kubëza betoni,
- MM, për bashkëfinancim me komunitetin për rregullimin e rrugës “Hamdi Krasniqi” me kubëza betoni,
- MM, për bashkëfinancim me komunitetin për rregullimin e rrugës “Naim Zahiti” me kubëza betoni,
- MM, me Ministrinë së Punës dhe Mirëqenjes Sociale dhe KK-së, për punësim sezonal të popullatës rurale,
- MM, në mes të Komunës me fsh. Bukosh për shtruarje të rrugës me kubza betoni,
- MM, në mes të Komunës dhe KRM “Uniteti”, Mitrovicë për pastrim të deponive ilegale të mbeturinave (sigurimi i derivateve të naftës nga komuna),
- MM, me MKRS për gërmime arkeologjike dhe restaurim të Kalas së qytetit,
- MM, me MAPL për bashkëfinancimin e projektit “Renovim i objektit të ish TMK-së” (korrigjim i marrëveshjes),
- MM, me I“IADK”, i referuar si iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë në Republikën e Kosovës,
- MM, për bartje të pronës së paluajtshme nga programi “Gratë për Gratë” në emër të komunës,
- MM, me Organizatën Heifer International Kosova “HPI Kosova” për përkrahje të blegtorisë,
- MM, me “IADK” për përkrahje të fermerëve,
- MM, me Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë për themelimin e qendres për regjistrim të bizneseve në K. e Vushtrisë,

- MM, për ndërrim të pronave të paluajtshme, me KEK-un për rregullimin e shtratit të lumit Tërstena,
- MM, me GLV për bashkëfinancim për rregullimin e oborrit të shkollës me infrastrukturë përcjellëse në fshatin Reznik,
- MM, dhe bashkëpunim, me rrjetin rinor “BELLS Kosova” për mbrojtje të mjedisit,
- MM, me MAPL për bashkëfinancimin e projektit për shtruarje me kubëza betoni të dy segmenteve rrugore të Rr.“Avni Kutillovci”,
- MM, me MAPL për financimin e projektit shtruarje me kubëza betoni rrugën “Jeton Terstena”,
- MM, me Ministrinë për Kulturë për mbështetje financiare për shënimin e manifestimit “Ditët e Hasan Prishtinës,
- MM, me Qeveria e Landit të Tirollit të Austrisë për ndërtimin e 4 garazheve për Njësinë e Zjarrfikësëve,
- MM, me USAID-in për ndërtim të rrugës në Prelluzhë.

III .

Në vijim do të pasqyrohet në pika të shkurta puna e secilës drejtori veç e veç ndërsa raportet e tyre iu dërgojmë në mënyrë elektronike në mënyrë që ju të keni mundësi të njoftoheni në mënyrë të hollësishme me punën dhe aktivitetet e tyre.

1. Buxheti dhe Financa

Komuna e Vushtrrisë me buxhetin e vitit 2010 ka parapa mbulimin e një numrit të madh të projekteve dhe në këtë drejtim janë arrit rezultate të knaqshme.

Buxheti përfundimtar sipas SIMFK (Sistemi i menaxhimit te financave ne Kosovë) arrin në 10,826,723.57 € ,nga kjo shumë buxhetore janë alokuar 10,389,889.35 €, të paalakuara kanë mbet 436,834.22 € nga të hyrat vetanake. Nga kjo shumë e mjeteve të alokuara që është përdor për mbulimin e të gjitha shpenzimeve gjatë vitit 2010 janë realizuar 9,955,030.63 €.Gjithashtu vlen të theksohet se nga mjetet e alokuara në fund të periudhës, të zotuarra kanë mbetur 167,671.58 € dhe mjetet të mbetura 680.937,85 €, sipas raportit të SIMFK-së. Shprehur në përqindje norma e realizimit të buxhetit është 95.81% nga mjetet e alokuara buxhetore për vitin 2010, mjetet të zotuarra kanë mbet 1.61%, mjetet të mbetura 6.55% dhe të pa alokuara 4.20%. Mjete të lira të bartura për vitin 2011 nga të hyrat vetanake janë 322.269.81 €

Të hyrat nga Granti Qeveritar:

Për Komunën e Vushtrrisë gjatë vitit 2010, janë ndarë mjete në shumë prej 8,822.235.00 € dhe të gjitha keto mjete jane alokuar dhe realizuar 8,793,599.37 € ose 99.68 % është realizuar që do të thotë se është arrit një shkall shumë e lartë e realizimit të këtyre mjeteve.

Realizimi i këtyre mjeteve sipas kategorive ekonomike është i dhënë në tabelën në vijim.

Fondi 10						
Njësia	Buxheti I					
Buxhetore	Planifikuar	ALO KIMET	SHPENZIMET	ZOTIMET	TË MBETURA	
	Janar- Dhjetor/2010	Janar- Dhjetor/2010	Janar- Dhjetor/2010	Janar- Dhjetor/2010	Janar- Dhjetor/2010	Janar- Dhjetor/2010
Pagat	5.445.231,00	5.445.231,00	5.428.523,24	0,54	16.707,22	
Mallrat & Shërbime	758.018,00	758.009,00	752.416,83	5.226,60	365,57	
Shebimet komunal	223.210,00	223.209,98	223.058,96	79,84	71,20	
Sumbvencionet dh	50.000,00	50.000,00	49.996,55	-	3,45	
Investimet kapital	2.345.776,00	2.345.776,00	2.339.603,79	245,14	5.927,07	
Totali	8.822.235,00	8.822.225,98	8.793.599,37	5.552,12	23.074,51	

Siç shihet nga tabela - planifikimi i buxhetit është 8,822,235.00 €, alokimi 8,822,225.98 €, zotimi 5,552.12 €, shpenzimi 8,793,599.37 € dhe mjete të mbetura 23,074.51 €, shprehur në përqindje, realizimi i buxhetit nga fondi 10 është 99.68 %.

Të hyrat vetanake nga fondi 21.

Gjatë vitit 2010 K. e Vushtrrisë ka shënuar një rritje të konsiderueshme në inkasimin e të hyrave vetanake për realizimin e projekteve kapitale. Me buxhetin fillestar ishin planifikuar 868,719.00 €, mirëpo shuma e tersishmne e mbledhur e te hyrave komunale eshte 1,184,642.80 €.

Realizimi i këtyre mjeteve sipas kategorive ekonomike është i dhënë në tabelën në vijim

Fondi 21						
Njësia	Buxheti I					
Buxhetore	Planifikuar	ALO KIMET	SHPENZIMET	ZOTIMET	TË MBETURA	
	Janar- Dhjetor/2010	Janar- Dhjetor/2010	Janar- Dhjetor/2010	Janar- Dhjetor/2010	Janar- Dhjetor/2010	Janar- Dhjetor/2010
Pagat	25.750,00	16.722,00	1.788,51		23.961,49	
Mallrat & Shërbime	160.000,00	147.643,00	122.535,86	385,54	37.078,60	
sherb.Komunale	10.000,00	-		-	10.000,00	
Sumbvencione	105.000,00	105.000,00	104.825,88	-	174,12	
Investimet kapitale	1.227.088,00	821.647,80	547.466,10	91.125,84	588.496,06	
Totali	1.527.838,00	1.091.012,80	776.616,35	91.511,38	659.710,27	

Siç shihet nga tabela, pjesa me e madhe e këtyre mjeteve ne shumën prej **547,466.10 €** është realizuar për investime kapitale, shuma prej 104,825.88 €, është shpenzuar për subvencionimin e transfere, shuma prej 122,535.86 €, për mallra dhe shërbime dhe shuma prej 1,788.51 €, për paga dhe mëditje kështu që shuma e tërësishme e shpenzuar e te hyrave vetanake te vitit 2010 arrin ne 776,616.35 €, mjetet e zotuara 91,511.38 €, dhe mjetet e lira buxhetore të fondit 21 do te barten ne buxhetin e vitit 2011 .

Të hyrat vetanake te bartura nga viti 2009 në vitin 2010 (fondi 22)

Shuma e tërësishme e mjeteve te bartura nga të hyrat vetanake te vitit 2009 ne vitin 2010 arrin në 516.943.80 €. Për një prezantim më të mire paraqesim tabelen në vijim:

Fondi 21						
Njësia		Buxheti I				
Buxhetore		Planifikuar	ALO KIMET	SHPENZIMET	ZOTIMET	TË MBETURA
		Janar- Dhjetor/2010	Janar- Dhjetor/2010	Janar- Dhjetor/2010	Janar- Dhjetor/2010	Janar- Dhjetor/2010
Fondi 22						
Pagat		76.584,25	76.584,25	69.845,55	-	6.738,70
Mallrat & Shërbime		-	-	-	-	-
sherb.komunale		5.000,00	5.000,00	4.961,56	-	38,44
Sumbvencione		1.010,00	1.010,00	1.000,00	-	10,00
Investime kapitale n		235.177,02	235.177,02	234.090,80	1.086,08	0,14
Totali		317.771,27	317.771,27	309.897,91	1.086,08	6.787,28

Nga tabela shihet se pjesa më e madhe e të hyrave të bartura është përdorur për investime kapitale në shumën prej 317,771.27 € , për subvencione janë shpenzuar 1,000.00 €, për paga dhe meditje shuma prej 69,845.55 €, mjete të zotuar kane mbete 1,086.08 € dhe të lira 6,787.28 € të cilat do të bartën në vitin 2011.

Te hyrat nga donatoret fondi 31

Ne vazhdim po e paraqesim tabelen e buxhetit dhe mjetet e shpenzuara nga fondi 31

Fondi 31						
Njësia		Shuma				
Buxhetore		Buxhetit	ALO KIMET	SHPENZIMET	ZOTIMET	TË MBETURA
		Janar- Dhjetor/2010	Janar- Dhjetor/2010	Janar- Dhjetor/2010	Janar- Dhjetor/2010	Janar- Dhjetor/2010
Pagat		-	-	-	-	-
Mallrat & Shërbime		22.100,00	22.100,00	13.376,00	972,00	7.752,00
sherb.komunale		-	-	-	-	-
Investime kapitale		136.779,30	136.779,30	61.541,00	68.550,00	6.688,30
Sumvencionet dhe		-	-	-	-	-
Totali		158.879,30	158.879,30	74.917,00	69.522,00	14.440,30

Shuma e mjeteve nga fondi 31 është 158,879.30 €, e alokuar është 158,879.30 €, mjete të shpenzuara janë 74,917.00 €, të zotuar janë 69,522.00 €, mjetet e mbetura do të barten në këtë vit.

Tabela përmbledhëse nga fondi 10,21,22,31

Tabela përmbledhëse nga të gjitha fondet buxhetore jep një të dhënë të qartë. Siq po shihet nga tabela mund të konkludojmë se buxheti i realizuar për vitin 2010 është 9,955,030.63 €, ose e shprehur në % - 95.81%

Njësia	Planifikimi i					
Buxhetore	Buxhetit		ALO KIMET	SHPENZIMET	ZOTIMET	TË MBETURA
	Janar- Dhjetor/2010	Janar- Dhjetor/2010	Janar- Dhjetor/2010	Janar- Dhjetor/2010	Janar- Dhjetor/2010	Janar- Dhjetor/2010
Pagat	5.547.565,25	5.538.537,25	5.500.157,30		0,54	47.407,41
Mallrat & Shërbim	940.118,00	927.752,00	888.328,69		6.584,14	45.196,17
Sherb.komunale	238.210,00	228.209,98	228.020,52		79,84	10.109,64
Investime kapitale	3.944.820,32	3.539.380,12	3.182.701,69		161.007,06	601.111,57
Sumvencionet dhe	156.010,00	156.010,00	155.822,43		-	187,57
Totali	10.826.723,57	10.389.889,35	9.955.030,63		167.671,58	704.012,36

Të hyrat vetanake për v.2010

- Sektori i tatimit në pronë:
- Gjatë vitit 2010 përpos punëve dhe detyrave tjera ka bërë shpërndarjen e faturave të ngarkimit të tatimit në pronë përmes PTK.
- Ka bërë regjistrimin e të gjitha ankesave dhe për të njëjtat Bordi i ankesave në kuadër të afatit ligjor ka dhënë përgjigjet.
- Për një pasqyrim të realizimit dhe rritjes së TP gjat vitit 2010 krahasuar me vitin 2009 po paraqesim këtë tabelë.

	Planifikimi 2010	Realizimi 2009	Realizimi 2010	INDEKSAT	
1	2	3	4	4:02	4:03
Tatim në Pronë	219,999.96	161,908.70	260,862.09	118.57	161.12

- Sektori i Financave publike:
- Në fillim të vitit 2010, janë përgatit aktvendimet mbi ngarkesën e taksës komunale dhe shpërndarja e tyre.
- Kanë shpërndarë vërejtjet për bizneset të cilat nuk e kanë kryer pagesën e taksës komunale,
- Ky sektor është furnizuar me një softuer i cili mundëson mbajtjen e shënimeve në nivel shumë të lartë profesional dhe raportimin e të dhënave për shkallën e pagesës së kësaj takëse.
- Për një pasqyrim më të mirë të inkasimit të taksës komunale po e japim tabelën në vijim:

	Planifikimi 2010	Realizimi 2009	Realizimi 2010		
1	2	3	4	4:02	4:03
Taksa në Firm	159,999.96	121,553.00	153,232.82	85.77	126.06

2. Prokurimi Publik

Të gjitha aktivitetet e prokurimit të realizuara gjatë v. 2010 qëllim themelorë kanë pasë që të sigurohet efikasitet dhe transparencë e mirëfilltë në mënyrë që shfrytëzimi i fondeve publike të bëhet konform rregullave përkatësisht ligjeve në fuqi me të cilat është e rregulluar kjo lëmi. Gjithashtu qëllim dhe objektiv tjetër ka qenë zbatimi i parimit të efikasitetit dhe ekonomizimit. Mjetet që janë planifikuar për projekte të caktuara nuk janë shpenzuar të gjitha për ato projekte. Sa për ilustrim po përmendim faktin që diferenca në mes të mjeteve buxhetore të planifikuara për projektet e v. 2010 dhe kontratave të nënshkuara është 688.494.21 €. Këto mjete janë shpërnda dhe ridestinue në projekte tjera.

Në periudhën raportuese, drejtoria për prokurim, ka iniciuar dhe realizuar 248 prokurime për t'i realizuar kërkesat për gjitha shtyllat e buxhetit të Autoritetit Kontraktues, si vijon :

- Administratë Komunale
- Arsim
- Shëndetësi
- Njësia e Zjarrfikësve
- Zyra lokale e komuniteteve, dhe
- Zyra për kthim të komuniteteve.

Në bazë të të dhënave nga raporti i detajuar i drejtorisë së prokurimit publik mund të shifet se gjatë vitit 2010 krahasuar me v. 2009 dhe 2008 kemi një rritje të prokurimeve si në aspektin e vlerës së mjeteve të kontraktuara ashtu edhe në aspektin e nr. të prokurimeve dhe vlerës së projekteve të realizuara. Gjithashtu është me rëndësi të ceket se nga të gjitha aktivitetet e prokurimit me theks të veçantë të prokurimet për punë në asnjë rast nuk ka pasë nevojë për punë shtesë që don të thotë se ka pasë një performancë të knaqshme sa i takon realizimit kryesisht si në kohë ashtu edhe në cilësi të ekzekutimit të projekteve.

Problemet dhe vështirësitë gjatë prokurimit: vonesat në disa raste të zotimit të mjeteve për projekte të caktuara, problemet herë pas herë pronësore me rastin e ekzekutimit të projekteve të cilat kanë ndikuar në dinamikën e realizimit me kohë të projekteve etj.

3. Ekonomi, Bujqësi, Pylltari

Është punuar në:

- rritjen e prodhimit të bujqësore përmes sistemit të ujitjes (nënshkrimi i marrëveshjes me MBZHR dhe ndermarrjen IBËR LEPENC për rehabilitimin e sistemit të pompimit dhe rrjetit të ujitjes në rajonin kadastral Samadrexhë ndërsa në vitin 2011 edhe me një projekt të njejtë edhe në fsh. Pantinë).
- gjetjen e donatorëve të jashtëm, ku kjo ka rezultuar me disa nënshkrim memorandumesh për bashkëpunim, si:
 - a) Memorandumi i Bashkëpunimit për 2011 me IADK-ën (Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë);
 - b) Memorandumi i Bashkëpunimit për 2011 me "Hejfer Kosova" (organizatë e mbështetur nga Qeveria Kanadeze në sektorin e blegtorisë);

c) Memorandumi i Bashkëpunimit me kompanin "Pestova" ;
Rëndësi të veçantë kemi kushtuar edhe bashkëpunimit me AZHR-Veri (Agjencin për Zhvillim Regjional-Veri), me të cilët kemi mbetur në proces të hartimit të strategjisë zhvillimore regjionale dhe me asistencën e të cilëve kemi konkuruar në KE (Komisionin Evropian) me tri projekte nga të cilat kemi fituar dy projekte në të cilat jemi partner me komunat e regjionit dhe me IADK-ën.

Projekti i parë është i fokusuar në zbatimin e katër komponentave, projekt ky që pritet të implementohet nga Iniciativa për Zhvillimin e Bujqësisë (IADK) dhe do të përfshijë këto komponente:

-Promovimin e Bujqësisë-Hortikulturës;

-Blegtorisë;

-Përpunimit të frutave;

-Trajnimit të fermerëve regjional;

Realizimi i projektit është i përmbledhur në një kosto prej 427.000 € me një kohëzgjatje për implementim prej 22 muaj nga janari/2011.

Gjithashtu në bashkëpunim me Ministrinë për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural kemi pasë një bashkëpunim të mirëfillt në përkrahje dhe subvencionim të fermerëve në blegëtori, pentari, perimkulturë etj. si dhe shërbime këshillimore gjegjësisht trajnime praktike.

Është realizuar poashtu projekti për ngritjen e 12 serrave secila në sipërfaqe prej 100 m².

Nga korriku i v. 2010 MBPZHR ia ka bartë kompetencat komunave në lëmin e pylltarisë. Staf i këtij sektori punën e tij e ka fokusuar në mbrojtjen e pyjeve. Në bashkëpunim me Policinë e Kosovës kanë ndërmarr masa ndaj prerësve ilegalë ku janë konfiskuar sasi e konsideruar e masës drunore si dhe janë ushtruar fletëparaqitje për kundravajtje dhe vepër penale në gjykatë për të gjitha rastet e gjetura të kësaj lëmie.

4. Arsimi

Sa i përket Arsimit lirisht mund të themi se prioritet ka qenë ngritja e cilësisë në mësim si dhe luftimi i dukurive negative që kanë qenë prezente në shkolla. Tani problemi i pozitës materiale të mesimdhënësve deri diku është përmirësuar. Hapësirat shkollore krahasuar me vitet e kaluara me ndërtimin e shkollave të reja kanë krijuar kushte dhe mundësi për zhvillim më cilësor të procesit mësimor. Për këtë janë dhënë mjete të konsiderueshme materiale buxhetore të cilat kopsiderojmë se kanë ndikuar në përmirësimin e kushteve të punës dhe mbarëvajtjen e rregullt të procesit mësimor. Mirëpo, edhe në këtë vit do të vazhdojmë të punojmë në ndërtimin e shkollave të reja, renovimin e atyre ekzistuese, rregullimin e ambientit të oborreve të shkollave etj. ndërsa sa i përket ngritjes së pozitës materiale të mesimdhënësve Qeveria dhe Kuvendi i Republikës së Kosovës shpresojmë se do ta zgjedhin brenda një kohe të shkurtë.

Nr. i nxënësve dhe paraleleve sipas niveleve shkollore

Niveli 1 (Klasa e parë deri të pestën), Në fillim i vitit shkollor 2009/2010 janë regjistruar 319 paralele dhe 7101 nxënës.

Niveli 2 (klasa e gjashtë deri të nëntën). Në këtë nivel janë 234 paralele me 5771 nxënës të regjistruar. Mësimi në Arsim të Mesëm i Ulët (6-9) mbahet i rregullt dhe vazhdimisht vlerësohet nga stafi përgjegjës.

Niveli 3 (kl.X-XIII). Në këtë vit shkollor 2009/2010 procesi mësimi mbahet në 127 paralele me 4250 nxënës.

Suksesi i nxënësve në procesin mësimor

Gjatë vitit shkollor **2009/10**, në shkolla fillore kanë qenë gjithsej 7100 nxënës, prej tyre me **sukses pozitiv 7052** nxënës ose **99.32%**, ky sukses pozitiv që ka qenë edhe në vitin e kaluar shkollor 2008/9 në fund të gjys.vj.të dytë. Kurse në gjysmë vjetorin e parë suksesi pozitiv ka qenë 96.25 %, që do të thotë suksesi në gjysmë vjetorin e dytë është ngritur për 3.07 % .

Në këtë vit shkollor, vërehet se numri i nxënësve në këtë nivel(kl.1-5) është në rënie e sipër, respektivisht krahasuar me vitin e kaluar shkollor 2008/9, numri i nxënësve në këtë vit shkollor është më i vogël për 134 nxënës. Arsyet janë të ndryshme e ndër ato supozohet, shpërngulja e familjeve brenda dhe jashtë Kosovës, rënia e standardit jetësor(planifikimi i familjeve), arsena shëndetësore etj.

Organizimi i mësimi në 3 shkolla fillore të qytetit në objekte të veçanta shkollore, në masë të madhe ka ndikuar në ngritjen e cilësisë së mësimi, disiplinës në punë, arritjen e rezultateve më të mëdha në punë, organizimin më cilësor të aktiviteteve të lira në shkollë, rregullimin e mjedisit shkollor etj.

Në arsimin e mesëm të ulët vijuan mësimet rreth 5771 nxënës në 29 shkolla fillore dhe të mesme të ulët. Me sukses pozitiv gjysmëvjetorin e dytë të vitit shkollor 2009/2010 e mbyllën 5672 nxënës, ose 98.27%. Duke e krahasuar me gjysmëvjetorin e parë ku 4062 nxënës apo 70.38% ishin pozitiv , pra kemi një rritje prej 27.89%.

Vitin shkollor e përfunduan 5752 nxënës ,ose 99.67%, kështu që vetëm 8 nxënës përsëritën shkollën , ndërsa 11 nxënës mbetën të pa notuar. Edhe në këtë nivel vërehen rënie të numrit të nxënësve. Ajo që duhet të na preokupojë është cilësia në procesin mësimor . Numri i nxënësve me sukses të shkëlqyer dhe shumë mirë nuk është në nivelin e duhur. Forcimi i këtyre nxënësve do të sjellë edhe ngritjen e cilësisë . Në këtë nivel duhet të punohet në ngritjen e klasave kabinet , që nxënësit të punojnë në mënyrë të pavarur, pra të ketë një lidhje në mes teorisë dhe praktikës.

Suksesi i tri shkollave të mesme të larta gjatë vitit shkollor 2009/10

Gjatë vitit shkollor **2009/10**, në shkolla të mesme kanë qenë gjithsej **4245** nxënës, prej tyre me **sukses pozitiv 4136** nxënës ose **97.43%**, . Kurse në gjysmë vjetorin e parë suksesi pozitiv ka qenë **26.50 %**, që do të thotë suksesi në gjysmë vjetorin e dytë është ngritur për **70.93 %** .

Gjimnazi “Eqrem Çabej”, ka gjithsej 1853 nxënës që me sukses pozitiv janë 1157 nxënës ose 62.44 % që krahasuar me gjysmë vjetorin e parë (498 nxënës me sukses pozitiv ose 26,87 %) është ngritur 35.57 % .

Shkolla e Mesme Teknike” Lutfi Musiqi “. që janë gjithsej 1258 nxënës që me sukses pozitiv janë 777 nxënës ose 61.76 % që krahasuar me gjysmë vjetorin e parë (285 nxënës me sukses pozitiv ose 22.66 %) është ngritur 39.1 % .

Shkolla e Mesme Profesionale ” Bahri Haxha “ ka gjithsej 1134 nxënës me sukses pozitiv janë 740 nxënës ose 65.25 % që krahasuar me gjysmë vjetorin e parë (313 nxënës me sukses pozitiv ose 27.63 %) është ngritur 37.62 % .

Problemet dhe vështirësitë. Ekzistojnë disa probleme me të cilat ballafaqohet arsimit në komunën tonë sikurse janë: nr. i vogël i nxënësve në disa shkolla me q’rast mësimi zhvillohet në disa klasë të kombinuara, mungesa e kabineteve të informatikes, mungesa e laboratorëve të kimisë, fizikes, biologjisë, mungesat e nxënësve, mungesat e arsimtarëve (për shkak të pushimeve mjeksore), mungesa e bibliotekave në disa shkolla etj. Këto probleme do të bëjnë përpjekje që të i zgjedhim në mënyrën më të mirë të mundshme. Megjithatë Drejtoria komunale e arsimit e cila është kompetente dhe përgjegjëse në bazë të legjislacionit në fuqi, duhet të bartë barrën kryesore të organizimit të mirëfillt të punës dhe arrijtjen e rezultateve sa më të mira në procin mësimor në të gjitha shkollat komunale

5. Administrata

Është punuar në:

- Menaxhimin e përditshëm të procedurave sektori i personelit në administratën komunale
- Identifikimin e nevojave për trajnim ku janë bërë trajnime të ndryshme të stafit ;
- Përcjellja e disiplinës në punë,
- Përcjellja e ligjshmërisë në punën e institucioneve të komunës si dhe informimi i kryetarit për këto çështje.

Kërkesat e qytetarëve për dokumentë personale:

Nr.	Përshkrimi	Gjithsejtë të lëshuara
1.	Certifikata të lindjes	34188
2.	Certifikata të martesës	7842
3.	Certifikata të vdekjes	1200
4.	Certifikata të Statusit martesor	1790

5.	Certifikata të shtetësisë	18311
6.	Certifikata familjare	2017
7.	Certifikata të kapacitetit martesor	0
8.	Certifikata të vendbanimit	17157
9.	Certifikata në jetë	105
10.	Akt i vdekjes	73
Gjithsejtë dokumente të lëshuara		82683
Regjistrimet në Regjistrat e gjendjes civile		
13.	Regjistrime në R. Lindjes	924
14.	Regjistrime në R. Martesës	770
15.	Regjistrime në R. Vdekjes	335
16.	Regjistrime në R. Shtetësisë	17177
17.	Regjistrime në R. Lindjes jashtë vendit	583
18.	Regjistrime në R. Martesës jashtë vendit	128
19.	Regjistrime në R. Vdekjes jashtë vendit	18
Gjithsejtë regjistrime të bëra		19935

6.

Urbanizëm dhe Mbrojtje të Ambientit

Përqendrimi dhe angazhimi themelor gjatë vitit raportues ka qenë:

- Përmeshja e detyrave dhe përgjegjësiqe që dalin nga strategjia e zhvillimit hapësinor të komunës sonë .

- Kordinimi i punëve rreth hartimit të Planit Rregullues të Qytetit si dhe shfrytëzimi sa ma racional i sipërfaqeve të tokës ndërtimore. Ky plan përmban gjithësejtë 17 pjesë (zona) i cili do të shqyrtohet dhe miratohet në disa faza duke përfshi në secilën fazë zona të caktuara. Në fazën e parë janë përfshi 3 zona të cilat kanë qenë në diskutim publik, ndersa tani pritet që së shpejti të miratohet nga kuvendi i komunës. Pjesët tjera të këtij plani do të miratohen gjatë v. 2011.

-Gjithashtu janë kryer punët dhe detyrat të cilat janë parashtruar nga qytetarët (sipas kërkesave të tyre) dhe organeve komunale në kuadër të ligjit dhe dispozitave tjera që e rregullojnë këtë fushë veprimtari.

-punët me interes të përgjithshëm për komunën. Ekspertët e kësaj Drejtorie kanë hartuar projektet dhe zgjedhjet ideore për projektet me interes të përgjithshëm për komunën.

-Mbikëqyrjen e projekteve që janë financuar nga mjetet buxhetore të komunës ose të donatorëve të ndryshëm që kanë vepruar në komunë,

-Pranimin teknik të punëve për projekte të caktuara etj.

Problem i veçantë që ende nuk kemi mundur ta zgjedhim është legalizimi i objekteve të ndërtuara pa leje. Megjithëse vitin e kaluar kemi bërë përpjekje që këtë problem ta zgjedhim me miratimin e rregullores për legalizim të objekteve të ndërtuara pa leje, kjo nuk u arrijt pasi që një gjë të tillë edhe pse u shqyrtue si pikë e veçantë e rendit të ditës në kuvend, nuk u aprovua për arsye që dihen.

Megjithatë në këtë vit kemi parapa që këtë qështje ta shtrojmë prap në rend të ditës në kuvend dhe dua të besoj se do ta miratojmë këtë rregullore.

7. Gjeodezi dhe Kadastër

Në këtë drejtori kanë arritur 3265 kërkesa prej të cilave në afatin ligjor janë zgjidhur – vendosur 3229 kërkesa, kurse në procedurë kanë mbetë edhe 36 kërkesa. Gjatë zgjidhjes – vendosjes të kërkesave, ka pasur probleme të natyrave të ndryshme, por me angazhimin e stafit profesional të këtij shërbimi të gjitha kërkesat janë zgjidhur në afatet ligjore duke respektuar të gjitha ligjet aplikative, urdhëresat administrative dhe aktet tjera nënligjore.

Në këtë Drejtori janë kryer punët gjeodezike dhe të kadastrit për nevoja të qytetarëve, nevoja të instituciove të komunës, gjykatave, organeve qendrore, Agjencionin kosovar të pronave, agjencionin kosovar të privatizimit dhe organizata dhe agjencione tjera sipas kërkesës ë tyre.

Vështërsitë që e kanë përcjellë gjerë tani dhe që vazhdojnë enda ta përcjellin janë mungesa e operatit origjinal kadastral i cili siq është e dijtur gjindet jashtë Kosovës, ndërsa uzurpimi i pronave publike nga qytetarë të pa ndërgjegjshëm është një problem lidhur me të cilin kemi ndërmarrë veprime. Këto veprime janë ndërmarrë kryesisht në pronat komunale ku janë realizuar projekte të infrastruktures, por ende nuk mund të jemi të knaqur sa duhet me masat që janë ndërmarr.

Komasacioni

Komisioni komunal për komasacion ka punuar ne projektin për komasacionin e tokave bujqësore për Komunën e Vushtrrisë te zbatuar nga kompania “GeoInfo” me seli ne Prishtine dhe te mbikëqyrura nga kompania “MM Consulting” po ashtu me seli ne Prishtine te kontrolluara nga Agjencia Kadastrale e Kosovës.

Shënimet e përgatitura nga kompania ne fjale janë dorëzuar tek komisioni Komunal ne forme digjitale dhe te përgatitura me ITF, Access dhe Excel si dhe rrjetat referente te dorëzuara ne forme digjitale dhe manuale për 14 Zona Kadastrale ne te cilat janë bere punimet e komasacionit. Nga kjo del se numri i Zonave Kadastrale të rregulluara me komasacion është 14 me sipërfaqe te përgjithshme prej 3339 ha.

Tani janë duke u kontrolluar dosjet për secilin pronar se a janë te gatshme për futjen e te dhënave ne RDPP.

8. Shërbimet Publike

Qështja e furnizimit me ujë të pijshëm tani siq e dijmë është në fazë të zgjidhjes pasi që në këtë vit pritet të filloj të ndërtohet fabrika për përpunimin e ujit, kështu që presim që ky projekt do të realizohet në bazë të dinamikës së paraparë. Me qëllim të kursimit sa më të madh të ujit nga rrjeti i ujësjellësit siç e dini në këtë vit kuvendi ka marr vendim për racionalizim te ujit e pijes dhe organet kompetente kanë ndërmarrë masa të mbikqyrjes së zbatimit e këtij vendimi.

Puna që është bërë në mbajtjen e higjienës në qytet ka ndikuar që në raport me vitet e mëparme të kemi një ambient më të pastër.

Drejtoria për Shërbime Publike ka një bashkpunim të mirë dhe koordinim të punëve me Kompaninë për menaxhim të mbeturinave “Uniteti” në mënyrë që të kemi një ambient sa më të pastër. Natyrisht se pengesë në menagjimin e mirëfillt me mbeturinat paraqet fakti

që komuna nuk ka ingerenca të duhura ndaj ndërmarrjes në fjalë e cila siq dihet vepron në nivel të regionit të Mitovicës. Mirëpo jemi në kontakte të herë pas hershme me Asociacionin e Komunave të Kosovës dhe me përfaqësues të Qeverisë së Republikës së Kosovës që kompanitë për menaxhim të mbeturinave të kalojnë në kompetencë të komunave.

Sa i përket sipërfaqeve publike siq dihet është bërë dislokimi i automjeteve Taxi nga Sheshi i Lirisë në rr. „Ramadan Fazliu”.

I është bërë gjithashtu një analizë e hollësishme gjendjes ekzistuese të komunikacionit në qytet, ku është bërë vendosja e shenjave horizontale dhe vertikale të komunikacionit në shumë rrugë të qytetit dhe rrugët e asfaltuara në fshatra, si dhe ndërtimi i pesë vend ndaljeve për autobusë së bashku me kabinat, i cili projekt është realizuar dhe financuar nga MAPL.

Është bërë mbikëqyrja për pastrimin dhe larjen e rrugëve dhe trotuareve, pastaj pastrimi nga bora gjatë sezonit të dimrit etj.

Është përgatitur dhe ekzekutuar plani për mirëmbajtjen e varrezave të dëshmorëve dhe ato në qytet.

Gjelbërimit të qytetit i është kushtuar gjithashtu rëndësi e duhur ku nga buxheti i komunës janë ndarë mjete të nevojshme financiare për gjelbërim të hapësirave publike në qytet. Eshtë përgatitur dhe me sukses është realizuar plani i gjelbërimit të 10 lokacioneve në qytet me sipërfaqe prej 5000 m² si dhe mbjellja e 634 drunjve dekorativ (blinj, gështenjë e shartuar, frashër i shartuar, bagrem i butë dhe tri lloje pishë). Punëtori për mirëmbajtjen e parqeve është angazhuar vazhdimisht për rrethimin, pastrimin, kultivimin, mirëmbajtjen dhe rregullimin e të gjitha parqeve por edhe të varrezave.

9. Mbrojtje dhe Shpëtim

Duke u nisur nga kompetencat e komunës në fushën e mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore dhe nga fatkeqësitë e tjera, Drejtoria komunale për MSH në kuadër të kompetencave të veta, ka bërë planifikimin për metodologjinë e hartimit të vlerësimit të rrezikut dhe Planeve për Mbrojtje dhe Shpëtim.

Për hartimin e vlersimit të rrezikut dhe planeve me propozim të Drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim, Kryetari i komunës ka formuar grupin punues profesional prej 12 antarëve, duke u bazuar në Udhëzimin administrativ për metodologjinë e hartimit të vlersimit të rrezikut dhe Planeve për Mbrojtje dhe Shpëtim.

Punët që janë kryer:

Në pjesën e parë të vitit 2010 ka pas të reshura të shumta të borës ku janë krijuar vështërsi të mdha në qarkullimin e automjeteve dhe njerzëve në qytet dhe rrugët lokale të fshatrave për rreth, për qka DMSH së bashku me DSHP janë angazhuar në pastrimin e borës dhe mënjanimin e pengesave eventuale nga të reshurat.

Gjatë kësaj kohe janë angazhuar kompanitë e specializuara për veprime në këto situatë.

Gjithashtu gjatë muajit mars ka pas të reshura të shtuara të shiut me qka janë shkaktuar vende vende vërshime: sipërfaqe bukur e madhe e tokave pjellore, kopshte rrugë puse të ujit të pijshëm.

Vërshime ka pas edhe në toka pjellore ku janë krijuar dëme të mëdha materiale në bujqësi, ky problem është një nga problemet që tani për tani e ngarkon situatën

emergjente në komunë, sepse dëmtimi i digave krijon mundësi që vërshimet të janë më të mëdha.

Zyra e Alarmimit me qëllim të përmirësimit dhe avansimit tekniko teknologjik ZAKE është furnizua dhe instalua një pjesë e sistemit të radio-komunikimit digjital, për nevoja të shërbimeve emergjente në komunën tonë si dhe një pjesë e cila do të shërbej për menagjimin e situatave emergjente për komandim në lëvizje.

Gjatë këtij viti raportues njësia e zjarrfiksive është pajisur me një autobot sulmues me kapacitet 3 t. me qka është rrit veprimi për reagim emergjent të njësisë të zjarrfiksive.

Inspektoret e parandalimit Gjate vitit 2010 Zyra e parandalimit i ka realizuar te gjitha detyrat ne baze te veprimtaris se vet: inspektimet, raportet, vendshiqimet (ne vendin e ngjarjes –zjarrit),

10. Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

Në lëmin e shëndetësisë gjithashtu janë shënuar rezultate të dukshme. Vitin që e lam pas u ndërtua Qendra e Mjekësisë Familjare në qytet në vlerë rreth 1.000 000 €. Në këtë qender do të krijohen mundësitë për ofrim të shërbimeve shumë më cilësore ndaj qytetarëve. Në këtë vit pritet që të filloi puna në këtë qendër shëndetësore. Gjithashtu në këtë vit u ndërtuan dy ambulanca shëndetësore, njëra në fsh. Beqiq ndërsa tjetra në fsh. Pasomë.

Spektori i shëndetit parësor dhe publik

Të dhënat e vizitave mjekësore dhe shërbimeve tjera shëndetësore në QKMF, QMF dhe Ambulanca shëndetësore i paraqesim në vijim:

-
- Gjithsejtë numri i pacientëve 159239-100.00%
 - Numri i pacientëve që kanë participuar..... 25785- 16.19%
 - Numri i pacientëve që janë raste sociale.... 31077- 19.51%
 - Fëmijët deri në moshën 15 vjeçare..... 50915- 31.97%
 - Të moshuarit mbi 65 vjet, kronikët, emerg.. 51462 – 32.31%

Janë krye gjithsej 462466 shërbime shëndetësore në QKMF, QMF dhe ASH, ndërsa numri prej 159239 pacientëve prej tyre 151044 janë trajtuar plotësisht apo shprehur në përqindje 94.85%, kurse janë udhëzuar në spital 8195 pacient apo e shprehur në përqindje 5.15%.

Shërbimi i vaksinimit

Shërbimi i vaksinimit gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2010 ka zhvilluar aktivitetet në ofrimin e shërbimeve të vaksinimit, duke e përfshirë grup-moshën prej: 0-11 muaj, 12-23 muaj, mbi 23 muaj, 6-7 vjet, 12-13 vjet, moshën 18 vjeçare të fëmijëve të planifikuar për vaksinim dhe rastet e lëndimeve të ndryshme.

- Të planifikuar për vaksinim prej 0-11 muaj kemi 1160 fëmijë.
Të vaksinuar kemi 1150 fëmijë ose 99.13 %
- Të planifikuar për vaksinim prej 12-23 muaj kemi 1125 fëmijë.
Të vaksinuar kemi 1122 fëmijë ose 99.7%
- Të planifikuar për vaksinim prej 6-7 vjet kemi 1355 nxënës.
Të vaksinuar kemi 1327 nxënës ose 97.93%
- Të planifikuar për vaksinim prej 12-13 vjet kemi 1454 nxënës.
Të vaksinuar kemi 1420 nxënës ose 98%

- Të planifikuar për vaksinim mosha 18 vjeçare kemi 820 nxënës.
- Të vaksinuar kemi 787 nxënës ose 96 % .

Mirëqenie sociale

Gjatë vitit 2010 janë pranuar 175 kërkesa për strehim, prej tyre janë realizuar 37 kërkesa ndërsa janë refuzuar 141 kërkesa për shkak të mundësive buxhetore.

Numri i familjeve që janë Subvencionuar nga KK Vushtri gjatë vitit 2010

Subvencione për Strehim	Subvencione për Shërim	Subvencione për Ushqim	Total
37 familje	64 familje	315 familje	416 familje
177.075.62	17.600.00 €	6961.00 €	200.636.62 €

Gjithashtu nga ana e Kolegjit Turk 240 familje skamnore kanë përfituar ndihma nga 5 kg mish për secilën familje me rastin e festës së Kurban Bajramit, ndërsa për familjet skamnore kemi pranuar donacion nga Komuna MAMAK-Turqi dy kamion ndihma me pako ushqimore dhe veshmbathje si dhe ndihmë humanitare nga qytetari Rexhep Haxha-Sfaraqk, miell në sasi prej 9273 kg.

11. Inspekcioni

Në këtë vit janë shënuar rezultate në punë të kësaj drejtorie. Janë ndërmarr masa nga ana e inspektorëve komunal si:

- inspektimet në pengimin e ndërtimeve pa leje ku kemi disa raste të rrënimëve të objekteve të ndërtuara pa leje në qytet.
- Gjithashtu janë ndërmarrë masa edhe nga inspektori I higjienes komunale,
- inspektimet e tregut,
- sanitarë etj.

Si rezultat i punës së kësaj drejtorie është rritë inkasimi i të hyrave vetanake si dhe shumica e bizneseve janë pajisur me leje komunale.

Megjithatë konsideroj se, ende ka vend për punë dhe angazhim edhe më të madh në ndërmarrjen e masave për eliminimin e problemeve dhe dobësive në teren. Inspekcioni i ndërtimitarisë posaçërisht duhet të bashkëpunojë dhe ta koordinojë punën me Drejtorinë e Urbanizmit dhe atë të Kadastrit për pengim të ndërtimit të objekteve pa leje.

Tabelari në vijim paraqet disa nga masat që ka ndërmarrë drejtorja e inspekcionit:

Nr. ren d.	Inspektorët	Nr.i procesverbaleve	Fletparaqitje	Aktvendime	Mbyllje të lokaleve	Gjoha mandatore	Vlera në € e gjobave	Mall i ndaluar nga shitja, vlera në euro	Mall i asgjasuar	Mall i asgjasuar në Kg
1	Inspektorët e Tregut 4	1020	7	72	60	60	2290,00 €	24.136,58 €		110
2	Inspektori Sanitar 1	437	2	46		6	380,00 €	24.136,58 €		
3	Inspektoët e Ndertimtarisë 2	120	41	69						
4	Inspektori i komunikacionit 2	201		66						
5	Inspektori i Mjedisit dhe Inspektorët e shërbimeve publike 3	341	5	180		13	320,00 €			
6	Inspektori i Veterinarisë 1	230					-			
-	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----	-----
7.	Totali	2349	55	433	60	79	2990,00 €	24.136,58 €	24.136,58 €	110 kg.

Bashkpunimi :

Me të gjitha Inspektoratet si të nivelit qendror dhe atij lokal , me Policinë e Kosovës si dhe me të gjitha strukturat tjera që kanë qenë në përputhshmëri me Ligjet dhe Udhëzimet Administrative të Inspektorateve të miratuara nga Kuvendi i Kosovës.

Malli i ndaluar nga shitja dhe i asgjasuar : 24.136,58 €

Malli me afat të skaduar është larguar nga shitja dhe asgjasuar në prezencën e pronarit-përgjegjës të subjektit afarist nga Inspektorati i Tregut dhe Inspektorati Sanitar.

Asgjasimet e mallrave me afat të skaduar apo mallra të dëmtuara janë dërguar në deponin e Gërmovës dhe në Bardhosh.

12. Kulturë, Rini e Sport

Në lëmin e kulturës janë bërë disa hapa siç janë; organizimet për manifestime të ndryshme dhe shënimin e disa datave të rëndësishme të komunës si: Shënimi i 17 shkurtit-ditës së pavarësisë së Kosovës, 5-6 dhe 7 marsi Epopeja e UÇK-së, 2 dhe 22 maji-përvjetori i masakrës në Studime dhe në qytet, fundi muajit maj – takimet e poeteshave shqiptare, 17 qershori, dita e çlirimit, 1 shtatori – dita e dëshmorëve etj.

Janë mbajtur edhe aktivitete të shumta kulturore në Qendren e Kulturës shfaqje teatrale, të muzikes, aktivitete rinore dhe sportive etj. Pastaj pjesmarrjet e shumta në festivale brenda dhe jashtë Kosovës ku Komuna jonë ka zënë vende të dalluara.

Është bërë pajisja e bibliotekës së qytetit në këtë vit me të rinj.

Në Muzeu komunal” janë organizuar vizita të shumta. Janë identifikuar sistemuar dhe regjistruar eksponate, fotografi etj.

Rinia: janë mbajtur takime të rregullta me OJQ rinore komunale, janë organizuar aktivitete me GTZ, trajnimeve të shumta me rini për fusha të ndryshme si: aftësim për punë, avokim, përpilim të projekteve, menaxhim, dizajnim, si dhe janë realizuar aktivitete tjera të shumta kulturore.

Sporti: Klubet sportive janë përkrahur financiarisht me mjete të buxhetit të komunës aq sa kemi pasë mundësi buxhetore nga fondi për transfero dhe subvencione, megjithëse mjetet që iu janë nda kanë qenë shuma simbolike për mbulim të një pjese të vogël të nevojave të tyre.

Të gjitha klubet poashtu janë liruar nga pagesa e shfrytëzimit të të gjitha hapsirave sportive për ushtrime dhe lojë.

13. Barazia gjinore

Në këtë kuadër janë kryer punë dhe aktivitete të cilat kanë ndikuar në përmirësimin e pozitës së femrave në komunë. Aktivitetet janë organizuar dhe zhvilluar nga zyrtarja për barazi gjinore në bashkëpunim dhe koordinim të ndërsjellë me stfin e komunës OJQ etj.

Në v. 2010 janë mbajtur dy tubime publike me qytetarë ku janë prezantuar të arriturat e komunës në gjashtëmuorin e parë të këtij viti si dhe janë diskutuar hallet, problemet përkatësisht kërkesat të cilat ata i kanë parashtruar. Ato kërkesa janë shqyrtuar në Bordin e drejtorëve ku një pjesë e tyre janë marrë parasysh me rastin e propozimit dhe miratimit të buxhetit të komunës dhe prioritetet e projekteve kapitale për v. 2011. Janë mbajtur edhe tubime tjera me qytetarë gjatë vitit raportues ku janë trajtuar probleme të ndryshme të qytetarëve si dhe mundësitë për zgjedhjen e tyre.

Në shtojcë të këtij raporti janë të paraqitur në mënyrë të detajuar lista e projekteve prioritare të planifikuara të vitit 2010 si dhe lista e projekteve kapitale të realizuara në v. 2010.

Kryetari Komunës
Bajram Mulaku



Tabela 4.2 Financimi vjetor i investimeve kapitale komunale për vitin 2010

Nr.	Komuna	Kod. i prog/n enprog	Progr am	Nën- Progr am	Kodi i projektit	Pip Kodi	Emri i Projektit	Plani 2010, nga i cili:						
								Kostoja totale	Ndryshimet (10)	Buxheti aprovar/fillestar (10)	Transferet qeveritare	Ndryshimet (21)	Buxheti i aprovar/fillestar (21)	Të hyrat vetanake
644	Vushtrri						TOTALE SHPENZIMET KAPITALE	3.572.864	400.000,00	1.945.776	2.345.776	553.369,00	673.719	1.227.088
		163	Administrata dhe personeli					20.000	(10.000,00)	10.000	-	-	20.000	20.000
		16324	Administrata					20.000	(10.000,00)	10.000	-	-	20.000	20.000
				81134	Paisje me teknologji informativ			12.000	-	-	-	-	12.000	12.000
				81135	Pershkrimi i librave amz			-	(10.000,00)	10.000	-	-	-	-
				81136	Servisimi i teknologjis informativ			8.000	-	-	-	-	8.000	8.000
		166	Inspektimet					20.000	-	-	-	-	20.000	20.000
				81137	Rrenimi i objekteve pa leje			20.000	-	-	-	-	20.000	20.000
		180	Shërbimet publike, mbrojtja civile, emergjencia					1.132.432	(5.078,00)	480.400	475.322	93.391,00	563.719	657.110
		18024	Infrastruktura rrugore					1.132.432	(5.078,00)	480.400	475.322	93.391,00	563.719	657.110
				81138	Ndërtimi i infrastrukturës rrugore dhe treguaret e infrastruktur përcjellse nëpër fshatra			184.014	14.014,42	-	14.014	66.281,00	103.719	170.000
				81139	Gjelbrimi dhe rregullimi i parqeve me mirëmbalje të varrezave			39.276	(10.724,02)	15.000	4.276	-	35.000	35.000
				81140	Fondi për Bashkfinancim.			175.000	-	-	-	-	175.000	175.000
				81141	Fondi për furnizim me material ndërtimor për			150.000	-	150.000	150.000	-	-	-
				81142	Furnizimi me qypa për kanalizim			52.890	-	-	-	2.890,15	50.000	52.890
				81143	Zgjerimi i rrjetit të ujësjellës në fshatrat rrez Qtaavices			150.000	-	-	-	-	150.000	150.000
				81144	Regullimi i fasadave të ndërtesave në qytet			14.220	-	-	-	(5.780,15)	20.000	14.220
				81145	Projekti renovimi i SHMP „Latif Berisha“			102.322	(10.078,00)	112.400	102.322	-	-	-
				81146	Rregullimi i silemit të ujit të pijshëm			65.000	-	65.000	65.000	-	-	-
				81147	Projekti për kthim në f.sh.Dolak Shtitacë			50.000	-	50.000	50.000	-	-	-
				81148	Punimi i pllakave perkultimore dhe bustave të			30.000	-	-	-	-	30.000	30.000
				81149	Renovimi i objektit të komunes			20.000	-	20.000	20.000	-	-	-
				81150	Ndërtimi i rrethosjes së Maxhunaj			5.053	(2.947,40)	8.000	5.053	-	-	-
				81151	Blerja e automjeteve për zjarrefikes			59.657	(343,00)	60.000	59.657	-	-	-
				81687	Blerja e automjeteve për Kryetarin e			30.000	-	-	-	30.000,00	-	30.000
				81688	Blerja e aparatit fotokopijues			5.000	5.000,00	-	5.000	-	-	-
		470	Bujqësia, Pylltaria dhe Zhvillimi rural					20.000	-	-	-	-	20.000	20.000
		47024	Bujqësia					20.000	-	-	-	-	20.000	20.000
				81152	Ngritja e serave			20.000	-	-	-	-	20.000	20.000
		660	Planifikimi urban dhe mjedisi					1.888.500	275.249,00	1.183.273	1.458.522	379.978,00	50.000	429.978
		66425	Planifikimi urban dhe inspeksioni					1.888.500	275.249,00	1.183.273	1.458.522	379.978,00	50.000	429.978
				81153	Ndërtimi i infrastrukturës rrugore dhe treguaret e infrastruktur përcjellse nëpër fshatra			1.547.420	14.169,00	1.153.273	1.167.442	379.978,00	-	379.978
				81154	Hartimi i projekteve zbatuese			30.000	-	30.000	30.000	-	-	-
				81155	Hartimi i planit rregullativ urban			50.000	-	-	-	-	50.000	50.000
				81794	Blerja e orendive të KK			9.800	9.800,00	-	9.800	-	-	-
				81813	Asfaltimi i rruges Vushtrri - Doberluka			140.000	140.000,00	-	140.000	-	-	-
				81814	Asfaltimi i rruges Magjistrale-Bajiske			110.000	110.000,00	-	110.000	-	-	-
				81689	Blerja me Orto foto			1.280	1.280,00	-	1.280	-	-	-
		730	Shëndetësia dhe mirëqenia sociale					142.076	-	142.076	142.076	-	-	-
		74450	Shërbimet e shëndetësisë primare					142.076	-	142.076	142.076	-	-	-
				81156	Ndërtimi i QMF-se në fshatrat Beqiq dhe Pas			56.798	(3.202,00)	60.000	56.798	-	-	-
				81157	Ndërtimi i rrethosjes së QMF në (Nevolan, Ashlan, Druar dhe strovç)			9.926	(22.074,44)	32.000	9.926	-	-	-
				81158	Paisjet me inventar për QKMF e re			20.000	-	-	-	-	20.000	20.000
				81159	Paisje mjeksore për QKMF e re			22.320	-	22.320	22.320	-	-	-
				81160	Paisja me teknologji informativ			3.753	(1.247,00)	5.000	3.753	-	-	-
				81690	Paisje dhe inventar për QMF -Beqiq, Pasomë			19.202	19.202,00	-	19.202	-	-	-
				81843	Rregullimi i struktureve përcjellse në ambulances e fshatit Beqiq			10.077	10.077,44	-	10.077	-	-	-
				81161	Renovimi i QMF-ve			-	(2.756,00)	2.756	-	-	-	-
		850	Kultura, rinia dhe sportet					195.000	150.000,00	15.000	165.000	30.000,00	-	30.000
		85024	Shërbimet kulturore					195.000	150.000,00	15.000	165.000	30.000,00	-	30.000
				81691	Rregullimi i murit rrethues të Sh.Kultures			-	-	-	-	-	-	15.000
				81692	Renovimi i objektit të Arhivit			30.000	15.000,00	-	15.000	15.000,00	-	15.000
				81693	Blerja e paisjeve për zërim			15.000	-	-	-	-	-	15.000
				81815	Rregullim i fushes së sportit në kompleksin Harulla Shala në Akrahtice			38.699	38.699,00	-	38.699	-	-	-
				81816	Ndërtimi i qendres rinore në fshatin Akrahtice			44.317	44.316,60	-	44.317	-	-	-
				81817	Rregullimi i fushes së sportit në fshatin Akrahtice			22.595	22.594,80	-	22.595	-	-	-
				81845	Rregullimi i hapësirës së lire për rreth fushes së sportit në fshatin Akrahtice			44.390	44.389,60	-	44.390	-	-	-
				81162	Renovimi i kulmit të palestres sportive			-	(15.000,00)	15.000	-	-	-	-
		920	Arsimi dhe shkencat					154.856	(10.171,00)	115.027	104.856	50.000,00	-	50.000
		93690	Arsimi fillor					81.706	(83.321,00)	115.027	31.706	50.000,00	-	50.000
				81163	Renovimi i objekteve Shkollore			-	(115.027,00)	115.027	-	-	-	-
				81694	Renovimi i dyshemes në sh.f.A.Z.Qajupi			20.556	20.556,00	-	20.556	-	-	-
				81695	Ndërtimi i shkollës fillore në Zhilivodë			50.000	-	-	-	50.000,00	-	50.000
				81853	Rregullimi i oborit në sh.f.Reznik me infrastruktur përcjellse			4.900	4.900,00	-	4.900	-	-	-
				81854	Rregullimi i infrastruktur përcjellse në sh.f.Vesekovc			6.250	6.250,00	-	6.250	-	-	-
		94890	Arsimi i mesëm					73.150	73.150	-	73.150	-	-	-
				81698	Renovimi i dyre dritare, dysheme në Gjymnaz			40.349	40.348,52	-	40.349	-	-	-
				81855	Paisje me Orendi - banka për shkollat e mesr			8.501	8.501,48	-	8.501	-	-	-
				81697	Renovimi i dyshemes në sh.m.L.Musiqi			24.300	24.300,00	-	24.300	-	-	-